

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 1991/2 VENDIMIT

V E N D I M
“I GJYQTARIT TE VETEM”

Ne Tirane, sot, me date 28/8/ 2001 une Gjyqtarja e kesaj Gjykate
Alumil Kalludhi mora ne shqyrtim kerkesen per depozitim ne
regjistrin tregtar te vendimit nr.4 date 17.08.1988 te Asamblese se Ortakeve te
shoqersie tregtare “ ALUMIL ALBANIA ” shpk dhe dokumentave te tjera te
paraqitura nga perfaqesuesi me prokure i shoqerise Sotirios Bulios .

K O N S T A T O V A

Me vendim nr. 19911 date 17.08.1998 te Gjykates se rrethit Tirane eshte
regjistruar si person juridik shoqeria “ALUMIL ALBANIA ” shpk me seli ne
Tirane.

Ne baze te Aktit te Themelimit si dhe te statusit te saj si dhe te shteses se kapitalit
me vendim nr. 19911/1 ajo eshte krijuar dhe aktualisht jane kater ortake. Shoqeria
Anonime “ Alumil Milonas -Aluminium Extrusion Industry AE “ me seli ne
Zona Industriale Stavrohorio Kilkis e perfaqesuar nga z.Giorgios Mylonas, me
kapital 94%, Georgios Mylonas me kapital 2%, Evangjelia Mylona me kapital 2%
dhe Majlinda Kalludhi per vete dhe per dy femijet e (trashemgimtare ligjore te
ortakut Panajot Kalludhi) me kapital 2%. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte
270.000\$.

~ Aktualisht asambleja e ortakeve me vendimin e saj nr.4 date 18.07.2001 ka
vendosur : 1-Te pranoje bashkimin me shoqerine “ALUSHQIP ” shpk Tirane ne
formen e perthithjes.:

2-Te miratoje projektin e bashkimit te dy shoqerive (bashkelidhur vendimit)

3-Te caktoje eksperte kontabel Mimoza Sula , e autorizuar per te bere vleresimin
e kapitalit te shoqerise “ALUMIL ALBANIA” shpk Tirane .

4-Te pranoje ortak ne shoqeri ne vend te ortakut Panajot Kalludhi i cili ka
vdekur date 27.08.2000 trashegimtarete e tij ligjore bashkeshorten Majlinda

Kalludhi , dhe dy femijet e mitur Enea Kalludhi , dhe Dhimitra Kalludhi , te cilat perfitojne nga 1/3 pjese secili ne pasurine trashegimore. Ortakja Majlinda Kalludhi do te jete perfaqesuese dhe administratore e dy femijeve te saj te mitur ne kete shoqeri ,

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimim e vendimit nr.4 date 18.07.2001 te Asamblese se Ortakeve ne regjistrin tregtar .

Kerkesa eshte e drejte dhe si etille duhet pranuar .

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjes 7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar" dhe ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" .

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimim ne zyren e Regjistrin Tregtar te vendimit nr.4 date 18.07.2001 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ALUMIL Albania" shpk:
- Shenimi ne fleten perkatese ne kolonen Grf .
- Regjistrimet te behen me nr. Rendor 2 duke u ndare nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

